

Lindita Latifi Xhanari (2022), *Arnavutçadaki Türkçe Alıntılar* (Turqizmat e gjuhës shqipe), Ankara

Përgatitja e një fjalori kërkon përgatitje metodologjike shkencore, por mbi të gjitha do studime të gjuhës/ve përkatëse. Por duket se vepra “Arnavutçadaki Türkçe Alıntılar” (Turqizmat e gjuhës shqipe) është përgatitur nga një person që nuk ka kryer studime të larta universitare për turqishten, arabishten dhe persishten dhe nuk është e specilizuar për njërën nga këto gjuhë. Kjo vërehet nga lëshimet tepër joprofesionale gramatikore që hasen në këtë vepër.

Në fakt në këtë recension nuk i kam nxjerrë të gjitha gabimet e lëshimet e bëra në fjalor, por thjesht me disa shembuj jam munduar të vë në pah një punë që nuk i plotëson kriteret minimale të përgatitjes së fjalorëve. Gjithashtu kam identifikuar edhe se, materiali që më ishte dorëzuar nga Instituti i Gjuhës Turke (TDK) për t’i bërë recensën, ishte si kopje identike e Fjalorit “Turqizmat e përbashkëta në gjuhët sllavo-ballkanike”, i botuar nga Lindita Xhanari Latifi në Universitetin e Pamukkalesë, Turqi, në vitin 2015. Një nga problemet më të mëdha që kishte libri ishte fakti se në parathënie, autorja thotë se: «Ka rreth 8500 fjalë në fjalor» (faqja 19), ndërsa e vërteta është se në këtë vepër ka vetëm 3017 fjalë. Sigurisht që në raportin tim të recensës kam argumentuar se vepra në fjalë, për shkaqe të mirëargumentuara, nuk duhet të botohet. Por Instituti i Gjuhës Turke (TDK) e botoi veprën, duke zvogëluar numrin e faqeve. Nga 487 faqe në librin që më ishte dërguar për recensë ishin hequr 187 faqe dhe e kishin botuar me vetëm 300 faqe. Tani në vazhdim do t’i sjellë vetëm disa shembuj për të vërtetuar argumentin tim se përse ky fjalorë nuk është dashur të botohej, sepse jam i bindur se jo vetëm që nuk i shërben dijes dhe shkencës, por dëmton edhe kredibilitetin e organit i cili e ka botuar edhe të vet autores.

ADI (I/E POSHTËR), Lindita L.Xhanari, Arnavutçadaki Türkçe Alıntılar, fq. 31.

Lindita Latifi Xhanari e cila e ka keqkuptuar Tahir Dizdarin, e ka përmendur fjalën ‘adi’ si turqizëm në gjuhën shqipe. Mirëpo në fjalorin e Dizdarit gjendet fjala *adi* (i poshtër), e cila nuk ka të bëjë aspak me *adilen* (të drejtën). Fjala *Adile* e gjuhës turke ka hyrë në shqip nga turqishtja nëpërmjet shprehjes gjykon sipas emrit. Turqizimet në

gjuhën shqipe janë përdorur për të përmendur dhe studiuar me detaje një ngjarje ose punë të caktuar.

ADLIYE (GJYKATA E LARTË), Lindita L.Xhanari, Arnavutçadaki Türkçe Alıntılar, fq. 31.

Lindita Latifi Xhanari, e ka keqkomentuar fjalën *adliye* të Tahir Dizdarit dhe nuk e ka vënë re që fjala e përdorur shumë shpesh si *adilije* në fjalorin e tij përmban krejt tjetër kuptim. Edhe pse në fakt, këto dy fjale janë krejt të kundërta me njëra tjetrën. *Adilije* e Dizdarit është një kartmonedhë që i përket viteve 1832 të periudhës Osmane me vlerën e 14 qindarkave përdorur në Goricë të Shqipërisë dhe fshatrat përreth dhe s'ka asnjë lidhje me terminologjinë e drejtësisë.

AKIL (MENDJE), Lindita L.Xhanari, Arnavutçadaki Türkçe Alıntılar, fq.32.

Fjala *akllëk/* (aklık) është një turqizëm dhe emër që ndodhet në fjalorin e Dizdarit dhe mban kuptimin e akllëkut që njohim ne, si produkt i lëngshëm me ngjyrë të bardhë që gratë e përdorin për të lyer fytyrën (produkt për makiazh). Por, siç mund ta shihni edhe më lart Lindita L. Xhanari e ka paraqitur këtë si *mendje*, ndërkohë që gjuha shqipe nuk ka një turqizëm të tillë.

BELGE (Dokument, certifikatë), Lindita L.Xhanari, Arnavutçadaki Türkçe Alıntılar, fq.47.

*belegi-ja* / (gur zmerilimi) Dizdari shkruan se guri i zmerilimit në shqip është emërtuar shumë shpesh si *belegi-ja*. Guri i zmerilimit është emër me kuptimin: Pjesë guri e hollë e përdorur për mbprehjen e mjeteve prerëse si thikë, biçak (thikë xhepi), gërshërë etj.

DARBUKA (TAMBURA) Lindita L.Xhanari, Arnavutçadaki Türkçe Alıntılar, fq. 70.

Vegël muzikore prej balte ose metali me një anë të hapur, e cila gellohet me dorë.

*taraba-ja* /(Tr).taraba *emër*, në gjuhën popullore perde dërrase. Në fjalorin e tij, Dizdari shkruan se perdet e dërrasës, ndryshe tarabatë janë përdorur në Shkodër rreth 35 vite më parë. ( Dizdari e përfundoi fjalkorin më 1970-ën). Lindita L.Xhanari këtë e ka ngatërruar *tarabanë me darbukanë*.

FIKIH (DIJE E SAKTË/ JURISPRUDENCË ISLAMIKE)

1. Njohja e mirë e një problemi a diçkaje. 2. *Fe*. Jurisprudenca Islame.

Lindita L.Xhanari, Arnavutçadaki Türkçe Alıntılar, fq.87.

*fiqir-i* /Tr. *fikir*. Është një turqizëm që ka zënë vend në gjuhën shqipe.

Lindita L.Xhanari e ka quajtur këtë *f ë .k ë* ~~Fjalët~~ *fikir* dhe *f ë k ë h* ndryshojnë si nata me ditën dhe në gjuhën shqipe nuk ekziston një turqizëm i quajtur *f ë .k ë h*

GAZAL, -LI (GAZELË) Lindita L.Xhanari, Arnavutçadaki Türkçe Alıntılar, fq. 91.

*gazel, gazela*/ Ata që kanë lexuar lletërsinë e Divanit e dinë mirë se ç'janë vjershat e shkurtra lirike (gazel) dhe odat (kaside). Lindita L.Xhanari e ka ngatërruar *gazel*-en me *gazal*, apo *gazelë* në shqip. Koncepte të letersisë së Divanit si *gazele*, apo odat është e mundur që t'i gjejmë edhe në të foluren e sotme mes shqiptarëve. Mirëpo, *gazal/gazelë* nuk ka qenë kurrë turqizëm.

GIRGIR 1.Fshisë mekanike. 2. *den*. Rrjetë e madhe peshkimi.

Lindita L.Xhanari, Arnavutçadaki Türkçe Alıntılar, fq.94.

*gurgule*,<sup>1</sup> *gurguleja*, *gyrgyle* /është një turqizëm shumë i rëndësishëm që ka kaluar në gjuhën shqipe. Tahir Dizdari e ka shpjeguar etimologjinë e kësaj fjale duke iu referuar fjalorit të osmanishtes “Kamus-i Türki” që përgatiti Sami Frashëri. *gulgule*: i. fa. 1. Zhurmë, britmë, zëra që vijnë nga çdo kokë: shpërtheu një zhurmë. 2. *dialekt* Zhurma që nxjerr derdhja e ujit nga një enë e ngushtë: tingulli i brokes së ujit. Lindita L.Xhanari këtë e quan GIRGIR.

INCE (I (E) HOLLË) Lindita L.Xhanari, Arnavutçadaki Türkçe Alıntılar,,fq.118.

Lindita L. Xhanari që e ka keqkuptuar, sepse *ince* (inxhe) nuk është turqizëm dhe s'është përdorur kurrë në këtë formë në gjuhën Shqipe. *Inxhe* (me kuptimin e kunatës) që ka përmendur Dizdari në fjalorin e tij është një turqizëm shumë i bukur, i cili përdoret ende edhe sot po aq sa në kohen e Perandorisë Osmane në shumë fshatra e provinca

---

<sup>1</sup> *gurgule, gurguleja, gyrgyle* /është një turqizëm shumë i rëndësishëm që ka kaluar në gjuhën shqipe. Tahir Dizdari e ka shpjeguar etimologjinë e kësaj fjale duke iu referuar fjalorit të osmanishtes “Kamus-i Türki” që përgatiti Sami Frashëri.

Shqiptare. Në Manastir, Dibër dhe Gorice turqizmi *inxhe* (kunatë) është përdorur edhe me variantin: *hanëm inxhe*, *inxhehanëm*. Ndërsa në familjet turke që jetojnë në Prizren dhe Mamushë, ky turqizëm ka zënë vend edhe me forma të tjera si: *büyük ince*, *küçük ince* (inxhe e madhe, inxhe e vogël).

KADINBUDU (Qofte me bulgur ose oriz e cila skuqet në vaj pasi është lyer me vezë), Lindita L.Xhanari, Arnavutçadaki Türkçe Alıntılar, fq.122.

*kadibogdan-i* / (Tr.) kadıboğan, është një lloj ëmbëlsire shumë e ngjashme me sheqerparen.

Dizdari tregon me krenari të madhe për kadibogdanin që gatujnë shqiptarët. E le të kthehemi tani tek Lindita L. Xhanari, e cila edhe pse është rritur në Tiranë s’e ka ditur kuptimin e kadibogdanit, ndaj e ka ngatërruar atë me “kadınbudu”.

KUL (ROB) 1.Rob, njeri i Zotit . 2. tar. Skllav . 3. hist. Skllav. (Lindita L.Xhanari, Arnavutçadaki Türkçe Alıntılar, fq.145.

*qul*, *qylçe* / (Tr) külçe. Shpjegimi i Tahir Dizdarit: külçe: i. 1. Metal i derdhur në një pjesë të vetme: kallëp/shufër floriri, argjendi ; shufër një ons-ëshe ari; një shufër dy onsëshe ari 2. Mineral që nuk është tretur ende: Shufrat që nxorrën nga toka i çuan në qytet për t’i përpunuar. (Yerden çıkardıkları külçeleri işletmek için şehre gönderdiler.) Lindita L.Xhanari s’e ka kuptuar këtë dhe e ka komentuar si “Rob i Perëndisë”, por ka gabuar.

KÜL (PLUHUR, HI) Pluhuri i mbetur pas djegjes së diçkaje, hiri. Lindita L.Xhanari, Arnavutçadaki Türkçe Alıntılar, fq.148.

Fjala *Qyl* është një turqizën tepër interesant në gjuhën shqipe, rrënjët e së cilës vijnë nga külli. Külli: mb. Ar. Kompleks (xhamie që përfshin bibliotekë, spital etj.) [nga fjala *küll* ] 1. I tërë , i lidhur, publik, kthim i papërfillshëm, plotësisht: Ar. 1. Plotësisht, e gjitha, tërësisht, krejtësisht: E mohon plotësisht. 2. [Në fjalitë mohore] aspak, kurrë, kurrësesi: Nuk kam aspak dijeni. Është e habitshme se si Lindita L. Xhanari e ka përngjasuar këtë me hirin që mbetet pas djegjes se zjarrit.

MAHZAR

1. Prania dhe prezenca e një personi me autoritet të lartë. 2. Kërkesë me shumë nënshkrime që i paraqitet një autoriteti të lartë, memorandum. 3. *drejt*. Regjistër gjykatë.

Lindita L.Xhanari, Arnavutçadaki Türkçe Alıntılar, fq.156.

Fjala *mahzun* nuk ka ndryshuar kurrë. Në shqip ajo ka po të njëjtin kuptim që mbart edhe në turqishten e ditëve të sotme, ndaj nuk është aspak e nevojshme që ta shpjegojmë duke u mbështetur tek Dizdari. Mirëpo, Lindita L.Xhanari, turqizmin mahzun e ka interpretuar me “mahzar”. Tërësisht e gabuar.

MALAK, -ĞI (VİÇ BUALLI), Lindita L.Xhanari, Arnavutçadaki Türkçe Alıntılar, fq. 157.

Turqizmi *malakta* është një fjalë e përdorur shumë shpesh në gjuhën shqipe, e cila ka zënë vend prej fjalës “muallak” të turqishtes. *Muallak* do të thotë: Punë e mbetur në pritje apo e papërfunduar, ose ndonjë çështje tjetër.

MUHALEFET

1. Të qenit kundër një qëndrimi, mendimi ose një sjelljeje, opozitë. 2. Grup njerëzish me pikëpamje të kundërta. 3. Një ose disa parti që janë jashtë qeverisjes në një sistem demokratik, opozitë.

(Lindita L.Xhanari, Arnavutçadaki Türkçe Alıntılar, fq.166.

*malufat-et, malyfate, mylefatë/* tr. muhallefât: is. cm. ar. Sendet e mbetura nga një i ndierë, pasuria: Pasuria e tij u regjistrua nëpërmjet një manovre ushtarake. Dizdari ka përmendur se kjo fjalë përdoret me të njëjtin kuptim, si në shqip ashtu edhe në Turqisht. Lindita L. Xhanari e cila nuk e njeh Osmanishten e ka quajtur këtë fjalë si *muhalefet*.

MÜREKKEP Gomar. Lindita L.Xhanari, Arnavutçadaki Türkçe Alıntılar, fq.163.

Fjala *myreqep-i, mereqep, mirekjep* është fjalë në gjuhën shqipe me prejardhje nga *mürekkep* e turqistes. “Mürekkep”i është bojë që përdorej për të shkruar. Ndërsa Lindita L.Xhanari e ka interpretuar si “gomar”.

NAL Një copë metali që u vendoset sipas formës së këmbëve duke iu ngulur në kthetra kafshëve të ngarkesës si kali, gomari ose kau. Lindita L.Xhanari, Arnavutçadaki Türkçe Alıntılar, fq.171.

*nallane-ja, nallë, nallëme, nallankë, tanallë/* tr. *nalın em*, Arapça *n a nallan* "Kishte nallane të madhësive të ndryshme në hamamet e pazarit." - Salâh Birsal. Fjala "nallane" në gjuhën shqipe përdoret në disa forma shqiptimi, por kuptimi i saj mbetet po i njëjtë. Ç'ë do që Lindita L. Xhanari *n a le* kamgatërruar me *nal* dhe është gabuar.

NÜZUL, -LÜ (Paralizë. )

Lindita L.Xhanari, Arnavutçadaki Türkçe Alıntılar, fq.175.

*nozull-i, nuzul, nozulë, nozullimi, me nozullue/* Kjo fjalë ka disa kuptime në gjuhën shqipe. Mirëpo, Tahir Dizdari ka shpjeguar se shqiptarët e kanë përdorur si: tr.nüzul: bujtje; të kalosh natën diku. nüzul emini = Personi që organizon nevojat e një ushtari të vendosur diku prej kohësh.

TEKE

1. Kec, cchap. 2. Një lloj karkaleci. 3. Një lloj deveje që përftohet nga kryqëzimi i një deveje leshatore mashkull dhe një deveje femër me gunga Lindita L.Xhanari, Arnavutçadaki Türkçe Alıntılar, fq.227. Tahir Dizdari këtë fjalë e ka shpjeguar si: TEKE -JA Shqipëri e mesme: 1. Pushkë me një tytë dhe një të shtënë të vetme, e cila është dy llojëshe: me kapsulë që mbushet nga gryka dhe lloji tjetër që thytet në mes si çiftja për t'iu vendosur fisheku<sup>2</sup>. 2. Pushkë e vogël brezi që e mbanin për t'iu argëtuar djemtë e rritur, që në Shkodër e quanin "cube", duke qenë se kishte një tytë dhe mbushej nga gryka. Lindita L. Xhanari këtë e ka quajtur "kec e cchap"?!

TEŞBIH (Ngjashmëri). (Lindita L.Xhanari, Arnavutçadaki Türkçe Alıntılar, fq.231.

*tespishte-ja, tespice, tespixhe/* Këtë turqizëm Tahir Dizdari e ka shpjeguar me fjalët: "Është një ëmbëlsirë e quajtur tez+pişti, sepse piqet shumë shpejt." Lindita L.Xhanari këtë e quan TEŞBİH/ ngjashmëri.

Jam i mendimit se këta shembuj janë dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar një punë pa kujdesë të mjaftueshëm shkencor. Me shpresë që as Instituti i Gjuhës Turke në Ankara e as autorja më nuk do t'i përsërisin gabimet e njëjta!

**Irfan Morina**

<sup>2</sup> Kjo armë është përdorur e përdoret masivisht nga gjahtarët shqiptarë